


RELACION

Projekti për Rrethimin e Tatrë Antik të Hadrianopolisit

(Rrënojat e Teatrit Antik, pranë fshatit Sofratik)

Monument kulture i kategorisë së parë

Vendimi Nr 1886 datë 10.06.1973



1. Hyrje.....	Error! Bookmark not defined.
2. Historia e Adrianopolit.....	6
3. Pershkrimi i kompozimit arkitektonik	Error! Bookmark not defined.
4. Pershkrimi konstruktiv	6
5. Pershkrimi i gjendjes ekzistuese.....	7
6. Konkluzione.....	6
7. Detaje te instalimit.....	7

Vasil
Polo

Digitally signed by
Vasil Polo
DN: cn=Vasil Polo, o=Klesta Otrici

Klesta
Otrici

Digitally signed by
Klesta Otrici
DN: cn=Klesta Otrici, o=Klesta Otrici

1. Hyrje

Hadrianopoli ndodhet në fshatin Sofratik rreth 500 m në lindje të rrugës nacionale (Gjirokastër-Kakavjë).

Hadrianopoli qëndron në vendin e një vendbanimi të mëparshëm të periudhës së vonë klasike dhe helenistike. Kjo ishte ndoshta një qendër shërbimi brenda territorit të luginës së lumit Drinos. Karakteristikat e tij ishin vendbanime të shpërndara dhe qendra të rëndësishme urbane, ndër të cilat disa fshatra të fortifikuara. Strukturat më të vjetra të gjetura i përkasin epokës së hershme perandorake: një tempull i vogël në kuadratet e operës dhe një strukturë rrethore e zhdukur më vonë nga teatri.

Një nekropol është gjetur të shtrihet në një zonë të konsiderueshme përtej kufijve urbanë. Pas një periudhe krize, e cila zgjati nga fillimi i shekullit IV dhe deri në fund të shekullit të 5 pas Krishtit, qendra e qytetit pati një ringjallje të përkohshme gjatë sundimit të Justinianit 527-565 pas Krishtit, kur mori emrin Justinianopolis. Gjatë kësaj periudhe ata ndërtuan një kishë të vogël brenda teatrit. Shtëpitë dhe dyqanet zinin zonën e banjave. Ata shkatërruan tempullin e vogël antik dhe e futën në një kompleks ndërtesash, ndoshta me funksion banimi. Ata e braktisën qytetin gjatë fillimit të shekullit të VII pas Krishtit. Megjithatë, emri i Drynopolis dhe peshkopata e tij vazhdoi të dëshmohet gjatë periudhave bizantine dhe mesjetare.

Vasil
Palo

Registruar në
Mbi 2021/11/23
128/16-128/2

2. Historia e Adrianopolit

Evidentimi i parë i teatrit, i përket me shumë mundësi arkeologut austriak K. Prashniker, i cili gjatë Luftës së parë botërore, sinjalizoi gjurmët e monumentit, që në atë kohë ndodhej ende nën tokë. Ndërsa më pas ishte N.G.L. Hammond, i cili, edhe pse i interpretoi gjurmët mbi teren si ato të një amfiteatri, e solli monumentin në vëmendjen e komunitetit shkencor. Teatri doli në dritë vetëm në fillim të viteve '70 nga A. Bace, kur gjatë realizimit të një kanali drenazhimi, i cili kalonte saktësisht në krahun e jashtëm të monumentit, u ndesh rastësisht me të, duke e nxjerrë në dritë gjatë fazës së parë të punimeve (fig. 5). Deri në vitin 2002, këto ishin strukturat e vetme arkeologjike të njohura në Sofratikë. Ishin pikërisht gjetjet më të fundit, ato që rritën vëmendjen mbi këtë zonë arkeologjike, dhe kjo ishte një arsye më shumë që bashkë me nevojën imediate për ta shndëruar në fitimprurëse këtë zonë në kuadrin e sistemit arkeologjik shqiptar duke qënë se ajo ndodhet në afërsi të një prej arterieve kryesore rrugore të Shqipërisë.


• Objekt me funksione termale

Kërkimet e kryera që prej vitit 2005, kanë ndihmuar për të zbuluar pjesë të një ndërtese të madhe, përballë teatrit (Ox7_5). Gërmimet e viteve të fundit kanë bërë të mundur që të identifikohen disa faza ndërtimi: një fazë e parë ndërtimi e dëshmuar nga dalja e një kanali të vogël, e inkadron kronologjikisht në fundin e shekullit të I pas Krishtit. Më vonë, me shumë mundësi, prej shek. II – III pas Krishtit, zona është bërë pjesë e një ndërtese të karakterit monumental i interpretuar si kompleks termal mbi bazën e planimetrisë.

Mendohet që ky monument i karakterit publik shfaqet në perendim në një hapësirë të gjerë përballë teatrit.




ORTOFOTO



PLANIMETRI E PERGJITHSHME E TERRITORIT TE QYTETIT

Zona arkeologjike gjendet në vend luginor plotësisht të rafshët, në një kuotë prej rreth 200 m mbi nivelin e detit, e kufizuar prej dy vargjeve malore me kuota më të larta se 1400 m mbi nivelin e detit


Zona është e mbuluar plotësisht nga një shtresë terreni aluvional me trashësi rreth 2,5 metra, me perjashtim të teatrit, që del prej saj, përshkohet nga një seri kanalesh drenazhimi që perdoren dhe janë përdorur në të kaluarën, për të evituar kënetëzimin si pasojë e grumbullimit të ujrave të shiut.



Vasil
Polo

01.01.2010
01.01.2010
01.01.2010

ADRIANOPOLI NE VITIN 2010



PLANIMETRIA E TEATRIT

3. Përshkrimi i kompozimit Arkitektonik¹

Adrianopoli ndodhet në Sofratike rreth 500 m në lindje të rrugës nacionale (Gjirokastër-Kakavjë). Teatri ka diametër 50 m dhe përafërsisht një kapacitet prej 4000 vetë. Ai përbën shëmbullin e vetëm në Ballkan të një teatri të ndërtuar në fushë të hapët. Ky teatër mendohet të jetë ndërtuar nga imperatori Adrian (117-138 pas Kr.). Gërmimet arkeologjike në këtë sit na japin elemente të rëndësishëm për identifikimin e këtij siti me qytetin e përmendur në Tabelën Peutingeriane (*Tab. Peut.* VII, 3) *Hadrianopolis*, qytet I themeluar nga Adriani për kontrollin, manaxhimin dhe shfrytëzimin e kesaj luge shume te begatë.

Teatri ka një formë planimetrike gjysëm elipsi me përmasa 40,4 x 51 m, krijohet prej një muri të jashtëm 0.90 m të gjerë, të përforcuar me kontraforte. Teatri përbëhet nga skena, orchestra 23 m e gjatë dhe shkallarja (cavea) e mbështetur në mbushje dhe e të përforcuar me tre mure perimetralë e terthorë. Hambare te tille kane qene ndertuar dhe ne ndertesat e tjera por qe sot nuk ruhen. Ne pjeset mbi cati jane disa tymare te cilat kane interes per shkak se mbrohen nga ererat me pllaka guri te medha.

Strukturat e banjave, të dukshme edhe sot në shekullin III pas Krishtit, zëvendësuan, duke zvogëluar përmasat e kompleksit të mëparshëm Adrianik.

Vasil
Polo

4. Përshkrimi konstruktiv

Teatri i Sofratikës është i ndërtuar tërësisht në terren fushor duke realizuar të gjithë konstruksionin me gurë e llaç gëlqeror. Teknika e muraturës në brendësinë e vet respekton atë romake duke aplikuar mbushje të tipit butobeton ndërsa sipërfaqet në dukje janë në rreshta gurësh gëlqeror, pothuajse të barabartë në spesor dhe me gdhëndje sipërfaqësore jo të imët. Janë përdorur gurë të medhenj vetëm në shkallare dhe pjesë të poshtëme të akenës e orkestrës.

5. Përshkrimi i gjëndjes ekzistuese

Hadrianopoli përfaqëson gjurmët e një qytetërimi tipik romak me teatër, me shkallë urbane, me mure të vogla që krijojnë atmosferën e jetës humane. Sipas studiuesve qyteti u ngrit nga perandori Adrian i cili hodhi themelet e një qyteti antik pas djegies dhe shkatërrimit të Antigonesë. Rrënojat e teatrit u zbuluan rastësisht gjatë viteve '70 të shekullit të kaluar. Shkallët prej guri që rrethojnë skenën, rradhët simetrikë që formojnë një gjysëm rrethi thuhet se kishin volum për të mbajtur qindra spektatorë.

Ne kete monument Kërkimet vazhdojnë për të zbuluar objekte të tjera të jetesës së banorëve të qytetit antik. Restauratorët kanë ndërtuar breza të vegjël me gurë për të ruajtur armaturat origjinale, falë të cilave kupton më mirë në imagjinatë kufijtë e qytetit të Hadrianopolit, pjesë e Parkut Arkeologjik të Antigonesë. Siti arkeologjik është i zbuluar nga bimësia dhe kjo i jep më shumë bukuri lashtësisë që jeton në ditët tona

¹ Rreferuar Kartelës të Monumentit


6. Konkluzione

Rrethimi i Adrianopolit perben nje rendesi te madhe per mirembajtjen e monumentit me vlera historike kaq te medha. Si e tille, kjo nderhyrje do te ndikojte ne hyrjen e kontrolluar te njerezve dhe kafshve te ndryshme, pasi duke qene ne zone bujqesore eshte rruge kalimit te kafshve . Propozimi i rrethimit eshte nje nderhyrje e domosdoshme per ruatjen e monumentit duke per te mos pasur demtime sidomos nga kalimi ne te i kafshëve te ndryshme.

7. Detaje te instalimit rethues.


Më poshtë japim një diagram të detajuar për montimin e gardhit rrethues i cila është konsultuar më Arkelog Prof. Roberto Perna, i cili udhëheq dhe misionin arkeologjik të Luginës të Drinos.

- Për një instalim të lehtë dhe afatgjatë është menduar vendosja e një gardhi rrethues me rrjetë metalike (rrjete e zinguar 50x50 mm) $\phi=2.8$ mm e veshur me pvc, ngjyrë jeshile për tu përshtatur me mjedisin në një lartësi prej 1.0 m.(shiko detajin Sipas Figurës 1)
- Rrjeta do të ketë dy kavo udhëzuese me diametër ϕ 4 mm rrezistente ndaj agjentve atmosferik, 10 cm mbi tokë dhe në pjesën e sipërme (fundore) të rrjetës.(Shiko detajin sipas figures 2)
- Kapja e rrjetës në tubin metalik do të bëhet me morseta cdo 25 cm lartësi.
- Tubo metalike të galvanizura me dimesione $\phi=50$ dhe $t=2.3$ mm dhe $H=1.5$ m, në distancë 2 m nga njëri tjetri, do të përdoren për të mbajtur rrjetën me thellësi inkastrimi deri në 50 cm (sipas Prof Pernës mund të gërmohet pa problem), dhe e inkastruar në beton me dimesion 25*25*25 klasa C 6/10.(shiko vizatimin për detajin teknik)
- Duke ndjekur figurën e parë më poshtë, do nevojiten: shtyllat e nisjes me një profil të vetm përforcues (A); Profili në qoshe, me 2 profile përforcuese në 90° (B); shtyllat e ndërmjetme, pa asnjë bulon (C1); dhe në fund shtyllat e përforcimit, me 2 bulona (C2) Shtyllat e armaturës janë të nevojshme çdo 30 metra linearë.
- Do të vendosen dy porta metalike në krahun verior dhe jugor të cilat do të përdoren si pikë aksesi nga vizitorët.
- Gjatësia e rrethimit është afërsisht 327 m




LLOJET E SHTYLLAVE

Vasil
Polo



INKASTRIMI NE BETON



PERCAKTIMI I NUMRIT TE SHTYLLAVE

Hapat per instalimin e gardhit rrethues


Vasil
Bashkëpunues

Pasi të vendoset për llojin e gardhit që do të instalohet, qoftë në tokë apo në kube betoni, hapi i parë është ai i konturimit të zonës që do të rrethohet, me një litar muratori, ku vendoset në vijë të drejtë mbi të cilën do të vendoset gardhi. Pasi të jetë skicuar zona që do të rrethohet, është e nevojshme të fiksohet sipas nevojës (në terren, ose në beton) skeletin e gardhit, si dhe shtyllat dhe bulonat. Do të fillohet me instalimin e shtyllave që do të vendosen në qoshe.


Shtyllat do të vendosen në kube betoni, ku duhet të hapen gropa me përmasa afërsisht 25x25x25 cm.

Pasi të jete mbushur gërmimi me llaç betoni, shtylla duhet të futet brenda derisa të prekë pjesën e poshtme dhe të qendrojë në vijë me litarin e vendosur, vertikaliiteti duhet të kontrollohet me një nivel.

Nëse shtyllat do të vendosen në tokë, gërmimi duhet të jetë afërsisht 50 cm.



SINJALIZIMI I VENDOSJES SE SHTYLLAVE




MONTIMI ME KUB BETONI

Vasil
Polo

Instalimi i telave te tensionit


Cdo shtyllë do të lidhet me tensionuesit përkatës të telit. Pasi të aplikohen tensionuesit në telat përkatës të tensionit (mundësisht në një distancë prej rreth 15 cm nga cdo shtyllë) duke përdorur me pincë ose mjetet perkatese , kalohet teli i tendosur përmes ingranazhit përkatës të i cili do të lejojë të Lejoje shtrengimin e telit te masen e duhet per ta bere gardgin sa me te forte dhe te qendrueshem.



VENDOSJA E TELI TE TENSIONIT

Instalimi dhe fiksimi i rrjetës

Hapi i fundit është instalimi i rrjetës, i cili duhet bërë në përgjithësi duke filluar nga një skaj i gardhit, duke e lidhur rrjetën me fijet e duhura lidhëse në shtyllë. Në këtë pikë mund të vazhdohet me zbërthimin e rrjetës përgjatë të gjitha shtyllave dhe të lidhen me rrjeten telat e tensionit dhe shtyllat përkatëse. Në skajin e fundit të gardhit, duke u siguruar që rrjeta të jetë e tendosur në çdo pikë, lidhja behet njelloj si për shtyllën e parë.



SHPALOSJA E RRJETES

Lloji i rrjetës

- Rrotulla e rrjetës duhet të vendoset në tokë dhe të shpaloset; lidhjet duhet të kontrollohen me kujdes
- Shiriti i parë i tensionit duhet të futet në fillim të rullit dhe duhet të ngjitet në shtyllën e nisjes; i dyti duhet të vendoset pranë shtylles së qoshes.
- Shufrat e tensionit duhet të lidhen me shtyllën, me ndihmën e tensionuesve.
- Më pas behet gershetimi i rrjetës duke zbërthyer fillin që e përbën atë; atëherë gardhi duhet të fiksoset në telat e tensionit, çdo 25 cm, duke përdorur fije të posaçme lidhëse ose kapëse të përshtatshme.
- Në çdo cep duhet të pritët rrjeta dhe pastaj të fillohet përsëri në një drejtim tjetër.

Konceptoi: Ing. Vasil POLO

Ing. Ardis Duka

Ark. Rodhalia Dhima